



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave  
“Bioteknologji Ushqimore”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Ariola Bacu

2. Prof. Dr. Adelaida Andoni

Prill/2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” ofruar nga**  
**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Univesiteti Bujqësor i Tiranës/ Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bioteknologji Ushqimore
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 391 datë 10.08.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr.7, datë 01.02.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikël i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14/9
18	Numri i studentëve: për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023	18, 13 dhe 15 studentë. Në total 46 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) e ushtron aktivitetin e tij mësimor-kërkimor bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij, Strategjinë e tij dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. UBT ka një përvojë të gjatë në fushën mësimore dhe kërkimore. Programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” i ciklit të dytë ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë dhe është pjesë e njësitë bazë të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky program ofrohet me kohë të plotë dhe është organizuar duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr. 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018”<sup>1</sup> dhe VKM Nr.185 dt. 25.03.2021<sup>2</sup>). Programi i ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” i përket nivelit 7 (shtatë) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i Studimit është i organizuar në 4 semestra me një kohëzgjatje prej dy vitesh akademike. Çdo vit akademik përbëhet nga dy semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS /në vit, në total 120 ECTS. Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” zhvillohet me kohë të plotë në 2 (dy) vite akademike në gjuhën shqipe. Lëndët e programit janë të ndara në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, dhe lëndë ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas Udhëzimit të MASR Nr.41, dt. 24. 01. 2018. Aktualisht, Departamenti “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” ka në përbërjen e tij personel akademik prej 14 pedagogësh me kohë të plotë, nga të cilët, 3 (tre) Prof. Dr., 3 (tre) Prof. Asoc. Dr., 6 (gjashtë) Dr. dhe 2 (dy) MSc.

<sup>1</sup> [https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_nr\\_41\\_date\\_24\\_1\\_2018\\_9fab9164a8.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_nr_41_date_24_1_2018_9fab9164a8.pdf)

<https://fshn.edu.al/Info/vkm/notifications/nr-41-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte>

[https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_Nr\\_879\\_date\\_18\\_12\\_2019\\_46b1a0c982.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_Nr_879_date_18_12_2019_46b1a0c982.pdf)

<sup>2</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/6.-vendim-2021-03-25-185.pdf>

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën **Prof. Dr. Ariola Bacu** dhe **Prof. Dr. Adelaida Andoni** si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL **Znj. Aleksandra Xhamo**.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit të studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” ofruar nga Univesiteti Bujqësor i Tiranës/Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë. Qëllimi i këtij raporti është të japë një vlerësim të pavarur për shkallën në të cilën Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë është i përgatitur dhe i angazhuar për të përmbushur standardet akademike të diplomave që lëshon. Për të arritur në këtë vlerësim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin bazohet veprimtaria e IAL (statuti, rregullorja, strategjia etj.), dosjen e programit të studimit, rregulloren e programit, dokumentacionin e sekretarisë mësimore si dhe takimet/vizitat të organizuara në institucion.


Më datë 23.03.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 38/38 Prot., datë 23.03.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 29.03.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 823/2 Prot., datë 30.03.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.1, Kriteri 6, GVJ vlerëson se Sektori i Karrierës dhe Alumnit funksion/ekziston jo vetëm në nivel universiteti por edhe në nivel fakulteti. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.4, Kriteri 4, GVJ vlerëson se nevojitet dhe rekomandohet pasurimi i laboratorëve të kërkimit shkencor me paisjet e nevojshme për të rritur mundësitë e studimeve të përparuara kërkimore e shkencore si dhe përfshirje

më e gjerë e studentëve të Programit të Studimit në projekte kërkimore. Rekomandimi mbështetet edhe nga GVB. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

3. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin IV.1, Kriteri 8, GVJ vlerëson se evidenca 90.3 mbështet kriterin përkatës. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
4. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin IV.2, Kriteri 4, GVJ vlerëson se evidenca 90.4 mbështet kriterin përkatës. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
5. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin IV.5, Kriteri 1 dhe 3, GVJ vlerëson se evidencat 90.6 dhe 90.9 mbështesin kriteret respektive. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
6. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin V.4, Kriteri 1, 2 dhe 3, GVJ vlerëson se evidencat 90.8 dhe 90.5 mbështesin kriteret 1,2 dhe 3. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
7. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin V.5, Kriteri 2, GVJ vlerëson se evidenca 90.7 mbështet kriterin përkatës. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**



5

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar Statutit (evidenca 1.0), Planit Strategjik 2016-2025 (evidenca 1.0.2) të Universitetit Bujqësor të Tiranës si dhe Rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” (evidenca 3, neni 2) rezulton se UBT/Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Bioteknologji Ushqimore është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e UBT-së, si dhe fushën e veprimtarisë. Ai synon ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore duke u fokusuar në objektivat e programit të cilat kanë për qëllim konsolidimin potencial të teknologjisë ushqimore në vend, përgatitjen e specialistëve në fushën e bioteknologjisë etj. Kjo evidentohet nëpërmjet evidencave 1.3.1 (Rregullore e Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit, neni 22), 1.11 (Rregullore e UBT-së, Kreu IV, neni 19).
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	GVJ konstanton se programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UBT-së (evidencat 1.0, Kreu VII, neni 56, 1.11). Programi synon njohuri të thelluara praktike dhe teorike në fushën e Bioteknologjisë Ushqimore në përputhje me fushat e drejtimet akademike të UBT-së.
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me nevojat e tregut (evidenca 1.5.1, Vendimi i hapjes së programit, evidenca 4, Studim tregu, evidenca 3, Rregullore programi, neni 2). Si i tillë ai është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit (evidenca 1.0.2, Plani Strategjik UBT 2016-2025).
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstanton se Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë</i>

	<i>ofron programe studimi që janë në përputhje me misionin dhe qëllimin e UBT-së dhe synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. Programi Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të UBT-së.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Referuar të dhënave mbi personelin akademik konstatohet se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë ka në përbërjen e tij personel akademik të kategorisë Profesor (3 Prof. Dr. dhe 3 Prof. Asoc. Dr.), personel akademik me gradën Doktor i Shkencave (6) dhe personel akademik në proces doktorature (2) (evidenca 8.2, Të dhëna mbi personelin akademik, evidencat 60.1, 60.2, 60.3, Tabelat e stafit akademik). Bazuar mbi këto të dhëna si dhe informacionet mbi infrastrukturën e Fakultetit/Departamentit (evidencat 26.1, 26.2, Infrastruktura në aspektin mësues, Infrastruktura laboratorike) rezultoi se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit "Bioteknologji Ushqimore" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit, përgjegjëse për programin e studimit. Kjo evidentohet nëpërmjet evidencave 1.3.1 dhe 8.1 (Rregullorja e Fakultetit, neni 38 dhe Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit) të cilat janë sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane në përputhje me LAL.
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	GVJ konstaton se programi i studimit "Bioteknologji Ushqimore" është emërtuar sipas fushës së studimit të Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë. Si i tillë fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë (evidencat 1.3, 5.3, 2.3, Rregullore e programit, Strategjia e zhvillimit të departamentit, Karakterizimi i lëndëve dhe kurrikula). Ai reflekton dispozitat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". Lëndët e planit mësues janë në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr.41, Dt. 24. 01. 2018, i ndryshuar.



<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi. Programi i studimit “Bioteknologji Ushqimore” është program Master i Shkencave.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Marrëveshjet institucionale me institucione të arsimit të lartë dhe biznese të fushës së ushqimit evidentohen nëpërmjet evidencave 22.2 dhe 22.3. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve UBT dhe Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit mundëson trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstanton se programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit si dhe Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë përgjegjës për këtë program.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ vëren se marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit sigurohen nëpërmjet Statutit dhe Rregullores së UBT-së (evidencat 1.0, 1.11). Ato synojnë mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Veprimtaria e UBT-së rregullohet përmes njësive akademike, organeve drejtuese si dhe atyre administrative në të gjitha njësitë kryesore (evidenca 50, Organigrama UBT). Mbikëqyrja e programeve në departament sigurohet nga Drejtuesi i Departamentit e evidentuar kjo në Rregulloren e departamentit (evidenca 1.4.2). Nëpërmjet ndarjes së detyrave brenda departamentit dhe analizave të vazhdueshme të punës (evidenca 21.1, Raport mësimor kërkimor i Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë) sigurohet mbarëvajtja e programit mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	UBT/Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve vendos marrëveshjet institucionale me institucione të arsimit të lartë dhe biznese të fushës së ushqimit të cilat evidentohen nëpërmjet evidencave 22.2 dhe 22.3. <a href="https://www.ubt-uni.net/sq/tag/marreveshje-bashkepunimi/">https://www.ubt-uni.net/sq/tag/marreveshje-bashkepunimi/</a>



	Një marrëveshje e rëndësishme e cila evidenton ndërkombëtarizimin e UBT/FBU-së është bashkëpunimi me Universitetin BOKU në Austri: <a href="https://ubgreen.al/universiteti-bujqesor-i-tiranes-dhe-universiteti-boku-i-vjenes-drejt-nje-bashkepunimi-afatgjate-ubt-boku-per-realizimin-e-strategjise-se-zhvillimit-ubt-2030/">https://ubgreen.al/universiteti-bujqesor-i-tiranes-dhe-universiteti-boku-i-vjenes-drejt-nje-bashkepunimi-afatgjate-ubt-boku-per-realizimin-e-strategjise-se-zhvillimit-ubt-2030/</a>			
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstanton se marrëveshjet e përmendura në kriterin 2 të këtij standardi (evidencat 22.2, 22.3) mundësojnë realizimin e praktikave nga ana e studentëve. Këto marrëveshje sigurojnë gjithashtu realizimin e punës kërkimore shkencore dhe mobiliteteve të personelit akademik dhe studentëve.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Referuar evidencës 21.01 (Analizat mësimore kërkimore e Departamentit), rezulton se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Analizat mësimore kërkimore të Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë evidentojnë ndër të tjera zhvillimin e praktikave, mobilitetin e stafit dhe të studentëve. kerkimin shkencor etj. (evidenca 21.01).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstanton se Universiteti Bujqësor i Tiranës/Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione e kompani brenda dhe jashtë vendit dhe i vë ato në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” i ofruar nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë është në përputhje me legjislacionin në fuqi (LAL dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018) dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i Studimit është program i ciklit të dytë, i organizuar në 4 semestra me një kohëzgjatje prej dy vitesh akademike. Çdo vit akademik përbëhet nga dy semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS /në vit, në total 120 ECTS. Kjo evidentohet nga evidencat 3 (Rregullore e programit të studimit), 1.3.1 (Rregullore e brendshme e njësisë kryesore), 2.1 (programet lëndore-syllabuset e programit), 66.1 (ndryshim kurrikule).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit dhe programeve lëndore (evidencat 3, 2.1) GVJ konstanton se programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” synon formimin e shprehive të veçanta dhe ofron larmi të gjerë profesionale e specialitetesh. Programi ofron njohuri të avancuara në fushën e studimit “Bioteknologji Ushqimore” si dhe mundësi punësimi (evidenca 4, Studim tregu), Ky program zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në fushën e bioteknologjisë dhe industrisë ushqimore duke i aftësuar studentët e diplomuar për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën përkatëse të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar Tabelës 9 ASCAL dhe evidences 66.1 (ndryshim kurrikule) GVJ vëren se programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” e ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse në përputhje me legjislacionin në fuqi (LAL dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>

ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
<b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UBT nuk klasifikohet si institucion e arsimit të lartë me status të veçantë.
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Konstantohet se programi studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” i ofruar nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë është emërtuar, organizuar dhe grupuar në kode që e identifikojnë atë me përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind me IAL të tjera (evidenca 1.0, Statuti i IAL, Kreu VII, nenet 53, 56).
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Referuar vlerësimit të Kriterit 7, të këtij standardi, GVJ vlerëson se programi studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” është grupuar në kode që identifikojnë fusha të ngjashme në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (evidenca 1.0, Statuti i IAL, Kreu VII, neni 53).
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi nuk ofrohet në bashkëpunim me IAL të tjera.
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” i ofruar nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Ai është në përputhje me LAL, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 si dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë është krijuar në vitin 2012 në përputhje me LAL. Në Statutin dhe rregulloren e IAL janë përcaktuar të gjitha detyrimet ligjore lidhur me programet e studimit. Referuar LAL neni 25, konstantohet se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë i përmbush detyrimet ligjore në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Konstantohet se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë ka në përbërjen e tij personel akademik të kategorisë Profesor, (3) Prof. Dr. dhe (3) Prof. Asoc. Dr., personel akademik me gradën Doktor i Shkencave (6) dhe personel akademik në proces doktore (2) (evidenca 8.2, Të dhëna mbi personelin akademik, evidencat 60.1, 60.2, 60.3, Tabelat e stafit akademik, Tabela 1 ASCAL). Departamenti ka 3 (tre) anëtarë personel ndihmës akademik (Tabela 1 ASCAL).</p> <p>Ai është i organizuar në grupe mësimore kërkimore struktura dhe organizimi i të cilave është në përputhje me LAL, Statutin e UBT-së (evidenca 1.0) dhe Rregulloren e Departamentit (evidenca 1.4.2).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Referuar vlerësimin të kriterit 1 të këtij standardi, evidentohet se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë ka 3 (tre) anëtarë personel ndihmës akademik (Tabela 1 ASCAL) duke përmbushur kështu detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ vëren se koordinatori i programit të studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" është Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë. Roli dhe detyrat e koordinatorit të programit janë sanksionuar në Statutin e UBT-së (evidenca 1.0, Kreu VII, neni 17).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson se Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit dhe Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë përgjegjës</p>

	<i>për programin e studimit "Bioteknologji Ushqimore" i përmbush të gjitha kërkesat ligjore dhe kriteret e përcaktuara në këtë standard.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" është hartuar në përputhje me legjislacionin dhe me aktet nënligjore (VKM Nr. 41 të MASR, Dt. 24.01.2018). Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin dhe strukturën e programit të studimit. Kjo evidentohet në kurrikulën e programit të studimit (evidenca 9.1) dhe programet lëndore (evidenca 2.1).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ konstanton se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, si njësi bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore", disponon dokumentacionin e plotë për programin e studimit. Ky dokumentacion është në zbatim të VKM-së për elementet e programeve të studimit dhe përmban, planin mësimor të programit të studimit ku përcaktohen lëndët e ndara sipas kategorive formuese me kreditet përkatëse, në vite e semestra dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik të angazhuar (Tabela 4 ASCAL). Informacionin mbi lëndët të grupuara në kategoritë përkatëse si lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore integruese, gruplëndë me zgjedhje, lëndë plotësuese (evidenca 9.1) si dhe programet e lëndëve (syllabus-et) (evidenca 2.1).
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ vëren se programi i studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" (evidenca 3, nenet 7, 14, 10, 15) përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabus-et) për secilën lëndë për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Konstantohet se programet e lëndëve (syllabus-et) (evidenca 2.1) dhe plani mësimor (evidenca 2.3) i programit të studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" përmban informacionet e nevojshme për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat, orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara nga ministria përgjegjëse.

<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Referuar evidencës 66 (Vendim i Senatit Akademik të UBT-së, Nr. 29, datë 23.09.2022) rezulton se përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm duke miratuar çdo fillim viti akademik ndryshimet eventuale (evidencat 2.1, 2.1.1, syllabuse shqip dhe anglisht).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se dosja e plotë e programit të studimit është e detajuar, informuese, e strukturuar dhe e organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore”.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstanton se programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e UBT-së dhe të Njësisë Kryesore (evidenca 1.0.1, AUT Strategic plan 2016-2025). Si i tillë emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive të studentëve dhe punësimin e tyre (evidenca 4, Studim tregu).
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Referuar programeve lëndore (evidencat 2.1, 2.1.1, syllabuse shqip dhe anglisht) vërehet se lëndët/modulet janë në përputhje me VKM Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr. 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018” <sup>3</sup> dhe VKM Nr.185 dt. 25.03.2021 <sup>4</sup> . Ato janë të shpërndara në vite e semestra, në kredite e orë mësimore duke mundësuar, në këtë mënyrë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit si dhe kërkimit shkencor.
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt	Bazuar në evidencën 9.1, vërehet se kurrikula e programit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” përmban 15 module dhe ngarkesa në kredite e secilit modul, raporti teori/praktikë është në

<sup>3</sup> [https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_nr\\_41\\_date\\_24\\_1\\_2018\\_9fab9164a8.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_nr_41_date_24_1_2018_9fab9164a8.pdf)  
<https://fshn.edu.al/Info/vkm/notifications/nr-41-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte>

[https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_Nr\\_879\\_date\\_18\\_12\\_2019\\_46b1a0c982.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_Nr_879_date_18_12_2019_46b1a0c982.pdf)

<sup>4</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/6.-vendim-2021-03-25-185.pdf>

me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare ( <a href="http://www.uni-hohenheim.de">www.uni-hohenheim.de</a> ). Veprimtaritë mësimore janë të ndara në, mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, etj.) në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (VKM Nr. 41 të MASR, Dt. 24.01.2018).
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Referuar evidencës 74, evidentohet se struktura mësimore përfshin veprimtari mësimore të përcaktuara sipas VKM Nr. 41 të MASR, Dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018” <sup>5</sup> dhe VKM Nr.185 dt. 25.03.2021. Këtu përfshihen lëndët të grupuara në kategoritë përkatëse si lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore integruese, gruplëndë me zgjedhje dhe lëndë plotësuese (evidencat 9.1, 72, Kurrikula e programit, plani mësimor). Një e ndarje e tillë e veprimtarive formuese si dhe raportet teori/praktikë mundësojnë arritjen e objektivave formuese të programit dhe transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim të studentëve të diplomuar.
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Referuar programeve lëndore (evidencat 2.1, 2.1.1, syllabuse shqip dhe anglisht) vërehet se ato përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë siguron teste bazë të shtëpive botuese të cilat përmbajnë njohuri të viteve të fundit.
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në Rregulloren e programit (evidenca 3) dhe bashkëpunimet në funksion të programit (evidencat 22.2, 22.3, Listë biznesesh bashkëpunuese, Lista e marrëveshjeve me institucionet) rezultojnë se programi garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Punësimi i studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës evidentohet nga evidenca 19.3 e cila jep një përmbledhje të punësimit të studentëve për periudhën 2016-2020. Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” siguron njohuri të thelluara të aspekteve të bioteknologjisë, inxhinierisë ushqimore, shkencave të ushqimit si dhe cilësisë ushqimore (evidencat, 2.1,2.1.1, 72, Plani mësimor, syllabuse shqip dhe anglisht).
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se struktura dhe organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënës, nivelin e kualifikimit sipas</i>

<sup>5</sup> [https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_nr\\_41\\_date\\_24\\_1\\_2018\\_9fab9164a8.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_nr_41_date_24_1_2018_9fab9164a8.pdf)

<https://fshn.edu.al/Info/vkm/notifications/nr-41-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte>

[https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_Nr\\_879\\_date\\_18\\_12\\_2019\\_46b1a0c982.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_Nr_879_date_18_12_2019_46b1a0c982.pdf)

	<i>Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe siguron kompetenca në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Standardi II.5</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ konstanton se për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë kryen kërkime periodike të tregut të punës duke përfshirë në të aktorë të ndryshëm nga Industria e Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Instituti i Shëndetit Publik etj. (evidencat 4, 19.3, Studim Tregu, Përmbledhje punësimi e studentëve 2016-2020).  GVJ konstanton se raportet mbi studimet e tregut dhe propozimet nga aktorë të ndryshëm përdoren me tej për hartimin apo përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Për të tërhequr mendimin e studentëve, GVJ vëren se IAL kryen anketime të vazhdueshme nëpërmjet pyetësorëve të ndryshëm rezultatet e të cilave përpunohen nga Komisioni i Rishikimit Periodik të Programeve të Studimit (evidencat 1.3.1, 77, Rregullore e brendshme e njësisë kryesore, neni 64, Pyetësor për studentët). Analizat e pyetësorëve përdoren si burim i vazhdueshëm në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në Rregulloren e brendshme të Njesisë Kryesore është saksionuar procedura e rishikimit periodik të programit të studimit (evidenca 1.3.1, nenet 90, 91). Vërehet se rishikimet, përditësimet në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fushës pasqyrohen në analizën mësimore kërkimore të Njesisë Kryesore/ Njesisë Bazë (evidenca 21.4.1)			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se UBT nxit përfshirjen e studentëve, aktorëve dhe organizmave të ndryshëm në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses të tij në përputhje me objektivat formuese.			



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.6

#### Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ vlerëson se Statuti i IAL-së (evidenca 1.0), Rregulloret e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë (evidencat 1.3.1, 1.4.2) përcaktojnë qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor të cilat vihen në funksion të plotë të programeve të studimit. Rregulloret e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë (evidencat 1.3.1, 1.4.2) janë në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Statuti i IAL-së (evidenca 1.0) dhe Rregulloret e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë (evidencat 1.3.1, 1.4.2) garantojnë të drejtën për organizimin e veprimtarisë të mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore-shkencore si dhe veprimtaritë krijuese duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e programit të studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nxitja dhe motivimi i studentëve në programin e studimit reflektohet në pjesëmarrjen e tyre në projekte, aktivitete kërkimore të Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë. Të tilla janë konferencat e ndryshme të organizuara nga Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë (evidenca 78, Konferenca me studentët, evidenca 74.1 Fotot të studentëve në mësim të hapura).			
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	GVJ vëren se në zbatim të Planit Strategjik të UBT-së, Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, mbështetet financiarisht nga ardhurat e siguruar nga projektet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare të pasqyruara në mënyrë të detajuar në analizat e punë mësimore dhe kërkimore (evidencat 21.01, 21.02).			
<b>Konkluzione</b>	<i>Gjetjet e GVJ për këtë standard janë si vijon: programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Ato janë të garantuara në Statutin e UBT-së dhe Rregulloret e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi II.7****Programi i studimit garanton njehuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Raportet punës mësimore dhe kërkimore të Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë pasqyrojnë projektet kërkimore-shkencore të cilat sigurojnë bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore dhe përdoren për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor (evidencat 21.01, 21.02). Këtu mund të përmenden projektet ERASMUS+ dhe NETCHEM. <a href="http://www.netchem.ac.rs/">http://www.netchem.ac.rs/</a>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Analizat e punës mësimore kërkimore (raportet vjetore) të përmendura në kriterin 1 të këtij standardi evidentojnë qartë angazhimin personelit akademik dhe studentëve në studime dhe projekte me karakter kërkimor shkencor (evidencat 21.01, 21.02, 21.4). Në analizat e punës mësimore kërkimore raportohen botimet në revista të ndryshme me faktor impakti. IAL ka infrastrukturë të pasur si laboratorë mësimorë-kërkimorë, qendër kërkimore (evidenca 26.2, Infrastruktura laboratorike) për zhvillimin e veprimtarisë mësimore kërkimore (evidenca 25, Lista e paisjeve laboratorike).
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në vijim të vlerësimeve të kriterëve 1 dhe 2 të këtij standardi konstantohet se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë organizon konferenca/aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave (evidencat 21.01, 21.02, 21.4).
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Përveç numrit të konsiderueshëm të ambienteve laboratorike që Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit zotëron, GVJ konstanton se IAL vë në funksion të kërkimit shkencor Qendrën e Kërkimit të Ushqimit e cila mundëson formimin e profesionistëve konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës (evidencat 21.01, 21.02, 21.4).
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi <sup>6</sup> (për referencë kriteri 6 i këtij standardi).
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi <sup>7</sup> . Referuar Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë, Neni 5, Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë janë profesionet e: a) mjekut; b) stomatologut; c)

<sup>6</sup> [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/LIGJ\\_NR\\_10\\_171\\_PRR.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/LIGJ_NR_10_171_PRR.pdf)<sup>7</sup> [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/LIGJ\\_NR\\_10\\_171\\_PRR.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/LIGJ_NR_10_171_PRR.pdf)

Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	farmacistit; ç) infermierit; d) mamisë; dh) fizioterapistit; e) veterinerit; ë) arkitektit; f) inxhinierit; g) mësuesit; gj) punonjësit social; h) psikologut.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" siguron njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Kjo reflektohet në përfshirjen e presonelit akademik dhe studentëve të programit në projekte të ndryshme ndërkombëtare.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në programet lëndore të programit (evidenca 2.1) të studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" konstantohet se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit, praktikatat profesionale etj., të cilat janë në përputhje me VKM Nr. 41 të MASR, Dt. 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", ndryshuar me VKM Nr 879, Dt. 18.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018" <sup>8</sup> dhe VKM Nr.185 dt. 25.03.2021 <sup>9</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në vijim të vlerësimit të kriterit 1 të këtij standardi vërehet se përvet formave të mësimdhënies, mësimnxënies të përmendura më sipër, personeli akademik përdor edhe metoda alternative dhe inovative si mësimi "online" i përdorur veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë (evidencat 33.1-33.4, Pagesat për platformën Zoom, Udhëzues për

<sup>8</sup> [https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_nr\\_41\\_date\\_24\\_1\\_2018\\_9fab9164a8.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_nr_41_date_24_1_2018_9fab9164a8.pdf)

<https://fshn.edu.al/info/vkm/notifications/nr-41-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte>

[https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_Nr\\_879\\_date\\_18\\_12\\_2019\\_46b1a0c982.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_Nr_879_date_18_12_2019_46b1a0c982.pdf)

<sup>9</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/6.-vendim-2021-03-25-185.pdf>

	zhvillimin e mësimit në distancë). Në këtë mënyrë, personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Mbështetja e institucionit në përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit akademik evidentohet në mobilitetet e stafit, projektet kërkimore, si dhe marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare (evidencat 10.2, 40.1, Mobilitetet e personelit akademik, CV e personelit akademik).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Referuar CV të personelit akademik (evidenca 40.1) konstantohet se stafi i angazhuar në mësimdhënien në proram in e studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Gjithashtu, bazuar në programet lëndore dhe planet kalendare (evidencat 2.1, 2.1.2), GVJ vëren se personeli akademik përdor metoda të ndryshme dhe interaktive të mësimdhënies, diskutime duke nxitur mendimin krijues, kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë tek studenti. Për sa më sipër personeli akademik siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë me studentët.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Bazuar në evidencat 34.1 dhe 34.2 (Pyetësorët për studentët), GVJ konstanton se Njësia Kryesore/Njësia bazë harton dhe shpërndan çdo vit akademik pyetësorët për studentët të cilët japin mendimin e tyre si dhe vlerësojnë format dhe metodat e mësimdhënies. Rezultatet e pyetësorëve të përpiluara në analizat mësimore kërkimore vjetore (evidenca 21.4) reflektojnë mendimet dhe sygjërimet e studentëve.
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UBT ka adaptuar metodat inovative të mësimdhënies si e-learning e cila promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies (evidenca 35, Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies). Promovimi dhe zhvillimi i këtyre metodave realizohet nëpërmjet angazhimit të stafit në projektin NETCHEM (evidenca 41), projektet ERASMUS (evidencat 10.2, Mobilitetet e stafit) etj. Kjo evidenton se IAL mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies dhe trajnon personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave inovative. GVJ konstanton se sigurimi i cilësisë evidentohet nëpërmjet Komisionit të Sigurimit të Cilësisë i cili promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies (evidenca 1.2.0, manual i cilësisë).
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se UBT garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor duke vënë në përdorim metodat inovative dhe</i>

	<i>praktikat më të mira, me në qendër studentin, të cilat sigurojnë arritjen e pritshme të rezultateve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.2</b>				
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e UBT-së (evidenca 1.11, Kreu IX, nenet 56-58) dhe Rregullorja e programit të studimit (evidenca 3, nenet 16-20) përcaktojnë kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve, aftësive profesionale dhe shkencore të cilat janë publike në faqen elektronike të IAL-së. <a href="https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve">https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve</a>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të përshikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Personeli akademik i programit të studimit informon çdo fillim viti akademik studentët në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të cilat evidentohen qartë në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullarët e lëndëve/moduleve (evidencat 2.1, 1.11, Programet lëndore, Rregullore e UBT-së).			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ vëren se mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore përshkruhen qartë në programet e lëndëve dhe moduleve (evidencat 2.1, 1.11, Programet lëndore, Rregullore e UBT-së). Mënyrat e ndryshme të testimit dhe vlerësimit (detyra kursi, projekte etj.) i mundësojnë studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë procesit të mësimnxënies.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se Njësia Kryesore/Njësia Bazë ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve dhe garanton zbatimin e tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi III.3**  
**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstanton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Kjo evidentohet në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit (evidenca 2.1), në planet kalendarike (evidenca 2.2.1) dhe është sanksionuar në Rregulloren e UBT-së (evidenca 1.11, Kreu IX, neni 56) dhe në Rreguloren e Njesisë Kryesore (evidenca 1.3.1, neni 58).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ vëren se IAL gjatë periudhës së pandemisë vuri në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. Këtu mund të përmendim zhvillimet online të provimeve nëpërmjet “google meeting” (evidencat 31.1-31.3). Në përdorim janë vënë edhe sistemet elektronike si;  <a href="https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.avhome.do/">https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.avhome.do/</a>  <a href="https://www.ubt.pitagora.rash.al/login">https://www.ubt.pitagora.rash.al/login</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin e programit lëndor (evidenca 2.1) dhe Rregulloren e UBT-së (evidenca 1.11, Kreu IX, neni 56). Si i tillë, GVJ vlerëson, se ai është në përputhje bazën ligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Njesisë Kryesore (evidenca 1.3.1), evidentohet se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin që të përmirësohet në të ardhmen. Pas shpalljes së rezultatit të provimit, studenti brenda 48 orëve paraqitet para komisionit për të parë provimin dhe për t’u sqaruar në lidhje me pikët dhe vlerësimin përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Nenet 57 dhe 63 të Rregullores së Njesisë Kryesore (evidenca 1.3.1) parashikojnë shmangien dhe nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Personeli akademik monitoron studentët gjatë zhvillimit të provimeve dhe kujdeset që gjatë detyrave të kursit të shmangjet mundësia e kopjimit apo plagjiaturës.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ evidenton se rezultatet e provimeve hidhen në sistemin elektronik brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren së Njesisë Kryesore (evidenca 1.3.1, neni 63). Vlerësimi bëhet me pikë të cilat konvertohen në notën sipas përcaktimeve në programet lëndore (evidenca 2.1).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar Rregullores së Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit (evidenca 1.3.1, neni 63), studenti brenda 48 orëve nga hedhja e pikëve në sistemin elektronik mund të kundërshtojë rezultatin e provimit. Referuar Rregullores së Njesisë Kryesore (evidenca 1.3.1), komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin për vlerësimin.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit</p>	<p>GVJ konstanton se mbështetur në Rregulloren e Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit (evidenca 1.3.1, neni 64), studentit i jepet</p>



dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	e drejta të ankimeve rezultatin e provimit. Ankesa bëhet me shkrim dhe procedohet sipas rregullave të përfshira në Rregulloren e Njësise Kryesore.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ evidenton se UBT siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Procedurat e vlerësimit dhe ankimimit janë të sanksionuara në rregulloret përkatëse (Rregullore e Njësise Kryesore/Njësise Bazë).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi III.4

#### Programi i studimit garanton rritjen e aftësi krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Bazuar në kurrikulën e programit (evidenca 2.3) konstantohet se studentit i garantohej thellim i njohurive, zhvillim i aftësi profesionale dhe të veçanta shkencore. Struktura e programit është në përputhje me VKM Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr. 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018” <sup>10</sup> dhe VKM Nr.185 dt. 25.03.2021 <sup>11</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Njësia Bazë mundëson kurrikulën e programit (evidenca 2.3) edhe në gjuhën angleze. Kjo ofron mundësinë e zhvillimit të aftësi të veçanta tek studentit. GVJ evidenton se studentët e programit të ciklit të dytë kanë mundësinë që nëpërmjet programeve ERASMUS të ofruara nga IAL të zhvillojnë module të programit ose një pjesë të tyre në IAL të huaja (evidenca 36, Lista e studentëve ERASMUS). Kjo rrit aftësitë e komunikimit dhe të ndërveprimit tek studentët.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.	Kurrikula e programit dhe programet lëndore (evidencat 2.3, 2.1) evidentojnë se kompetencat dhe aftësitë që studenti fiton, analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të lëndës. Ato janë të paraqitura në kurrikulën e programit dhe programet lëndore (evidencat 2.3, 2.1). Personeli akademik i vë ato në dukje gjatë orëve të seminarit, orëve laboratorike, detyrave të kursit dhe i orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë	Procesi i mësimdhënies realizohet mbi bazë kompetencash që u jep studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në orët laboratorike

<sup>10</sup> [https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_nr\\_41\\_date\\_24\\_1\\_2018\\_9fab9164a8.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_nr_41_date_24_1_2018_9fab9164a8.pdf)

<https://fshn.edu.al/info/vkm/notifications/nr-41-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte>

[https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM\\_Nr\\_879\\_date\\_18\\_12\\_2019\\_46b1a0c982.pdf](https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_Nr_879_date_18_12_2019_46b1a0c982.pdf)

<sup>11</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/6.-vendim-2021-03-25-185.pdf>

<p>studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>dhe praktikat profesionale. Kjo evidentohet në kurrikulën e programit (evidenca 2.3) dhe në analizat vjetore mësimore kërkimore (evidenca 21.4.1). Takimet në mbledhjet e departamentit evidentojnë se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup për interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve apo çështjeve të caktuara duke krijuar një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore e shkencore (evidenca 32, Njoftim mbledhje departamenti). Kjo mundëson bashkëpunimin me IAL të tjera dhe pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete shkencore dhe mobilitete (evidenca 22.2, Lista e marrëveshjeve, evidenca 38, Pjesëmarrje e studentëve në konferenca shkencore, evidenca 36, Lista e studentëve ERASMUS).</p> <p><b>Rekomandohet pasurimi i laboratorëve të kërkimit shkencor me paisjet e nevojshme për të rritur mundësitë e studimeve të përparuara kërkimore e shkencore si dhe përfshirje më e gjerë e studentëve të Programit të Studimit në projekte kërkimore.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Evidenca 38 (Leksione të hapura nga profesorë të ftuar) është tregues se personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Referuar temave të diplomës (evidenca 29.1, Propozime temash), evidentohet se Njësia Bazë nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët. Bashkëpunimet me IAL apo kompani të ndryshme krijojnë mundësinë e mbështetjes financiare për studentët (evidenca 22.2, Lista e marrëveshjeve).</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" siguron rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët me qëllim zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit (evidenca 3), GVJ vëren se Njësia Kryesore/Njësia Bazë ka hartuar procedurat e posaçme për detyrimet përmbyllëse të studentit. Njësia Bazë përpilon listen e temave të punimit të diplomës (evidenca 29.3) dhe e vë në dispozicion të studentëve para realizimit të tyre. Procedurat për detyrimet përmbyllëse të studentit bëhen publike nga Njësia Kryesore.</p>



	<a href="https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve">https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve</a>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ evidenton se personeli akademik asiston studentët, duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të realizimit të punimit të diplomës (evidenca 29.3). Studenti mund të kontaktojë udhëheqësin e punimit të diplomës edhe nëpërmjet adresës/postës elektronike zyrtare. <a href="mailto:emër.mbiemër@ubt.edu.al">emër.mbiemër@ubt.edu.al</a>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Cikli i dytë i programit të studimit mbyllet me mbrojtjen e punimit të diplomës. Referuar Rregullores së Njesisë Kryesore (evidenca 1.3.1), konstantohet se Komisioni i Diplomimit miratohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit (evidenca 43, Komision mbrojtje diplome).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo njëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (evidenca 3, neni 19), GVJ vëren se personeli akademik/udhëheqësi i diplomës orienton studentët dhe i ndihmon ata në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i temës së punimit të diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e tij sipas rregullave të miratuara në Rregulloren e programit të studimit (evidenca 3). Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe pas miratimit përfundimtar studentit bën dorëzimin e punimit të diplomës dhe e paraqet atë para komisionit.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Referuar infrastrukturës laboratorike të Njesisë Bazë (evidenca 26.2) konstantohet se studenti asistohet për kryerjen e matjeve, analizave, testeve për të zhvilluar pjesën eksperimentale të punimit të diplomës sipas temave dhe fushës së studimit. Njësia Bazë garanton zhvillimin e punimit të temës së diplomës edhe jashtë institucionit (evidenca 22.3, Listë biznesesh bashkëpunuese).
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Referuar Rregullores së UBT-së (evidenca 1.11, nenet 14, 16) dhe Rregullores së Njesisë Kryesore (evidenca 1.3.1, neni 54), vërehet se në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës studentit vlerësohet me notë.
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në Rregulloren e Njesisë Kryesore (evidenca 1.3.1, neni 105) konstantohet se studentit ka të drejtë të pajiset me një kopje të plotë të programit të studimit të zhvilluar.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi	GVJ evidenton se referuar Rregullores së UBT-së (evidenca 1.11, Kreu VII, neni 44) IAL mban në formë të shkruar dhe elektronike:


kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistrin themeltar (bazë) të studentëve</li> <li>• Regjistrin e arritjeve akademike</li> <li>• Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave</li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se UBT ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit të përcaktuara në Rregulloren e IAL dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>				
<b>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky standard/kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky standard/kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky standard/kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standard nuk aplikohet për këtë program studimi.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi i angazhuar në realizimin e programit MSc. në programin Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” përbëhet nga 5 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc. dhe 7 Dr. për vitet 2020-2021, 2021-2022 dhe 5 Prof.Dr., 3 Prof. Asoc., dhe 6 Dr. për vitin 2022-2023, nga të cilët 1 anëtar i kontraktuar. Në mbështetje të kriterit 1, institucioni ka ofruar evidencat 40. Lista e stafit akademik të angazhuar në MSH-BU, 40.1 CV e stafit akademik të MSH-BU, 40.2 Kualifikimet e stafit akademik, 8. Tabelë kualifikime Dep SHUB, 53. PAE-PAK Tabelat e stafit mësimdhënës MSH-BU, 60.1/2/3 Lista e stafit akademik me kohë të plotë, të pjesshme dhe administrative për vitet 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023, me anë të të cilave sqarohet niveli i kualifikimit dhe përputhja me fushën kërkimore në programin e studimit. Gjithashtu ofrohen evidencat 30.1 Përshkrim pune A. Cango 2020-2021, 30.2. Përshkrim pune L. Buzali 2020-2021, 30.3 Përshkrim pune E. Kopali 2021-2022, 30.4 Vlerësimi periodik i personelit ndihmës akademik, 41. Lista e stafit të anagazhuar në projektin NETCHEM, 41.1 Lëvizje të stafit akademik të FBM NETCHEM, 10.3 Mobilitet i stafit 2016-2021, 10.2 Lëvizjet e stafit DSHUB me anë të të cilave përshkruhet veprimtaria e stafit akademik dhe ndihmës akademik në favor të sqarimit të ekspertizës së tyre në drejtimin e moduleve brenda programit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në përputhje me Vendimin Nr. 418 të datës 10.05.2017” Mbi standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen bashkimin ose mbylljen e IAL dhe degëve”, rezulton se stafi i brendshëm mbulon 70% të ngarkesës mësimore. Nga gjithsej 14 anëtarë të stafit akademik, 11 janë nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, 4 nga Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe 1 nga Fakulteti i Zooteknikës, të UBT, të gjithë anëtarë me kohë të plotë për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022. Për vitin akademik 2022-2023 grupit ju shtua një anëtar i kontraktuar.</p> <p>Evidencat 24.1 Ngarkesa mësimore 2019-2020-DSHUB, 53.PAE-PAK Tabelat e stafit mësimdhënës MSH-BU, 60.1/2/3 Lista e stafit akademik</p>




	me kohë të plotë, të pjesshme dhe administrative për vitet 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Për të mundësuar mbulimin e programit të studimit me staf akademik për të gjithë periudhën e akreditimit, institucioni ka punësuar me kontrata të gjithë stafin akademik. Kontratat rinovohen sipas legjislacionit për të gjitha kategoritë e stafit. Në mbështetje të sa më sipër institucioni ka ofruar evidencat si vijojne: 40. Lista e stafit akademik të angazhuar në MSH-BU, 40.1 CV e stafit akademik të MSH-BU, 53. PAE-PAK Tabelat e stafit mësimdhënës MSH-BU, 60.1/2/3 Lista e stafit akademik me kohë të plotë, të pjesshme dhe administrative për vitet 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023, 61. Kontratë pune stafi.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	UBT ka hartuar dhe ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi mbështetur në kritere që mundësojnë përzgjedhjen e stafit akademik për realizimin e programit me cilësi. Mbi sa më sipër institucioni ka ofruar evidencën 1.1.1 Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës, në të cilin në Kapitullin V, në Nenet 48-56 përshkruhen politikat mbi rekrutimin e stafit.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në Departamentin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë janë të punësuar staf ndihmës akademik, i përshkruar në Tabelat 60.1/2/3 Lista e stafit akademik me kohë të plotë, të pjesshme dhe administrative për vitet 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023. Rezultoni se në të tre vitet akademike janë angazhuar 3 punonjës ndihmës akademike të diplomuar MSc., që dëshmon aftësi të mjaftueshme për realizimin e orëve mësimore dhe mirëmbajtjen e laboratorëve.
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Institucioni ofron dokumentacione në mbështetje të kriterit 6 si vijon: 8.2 Tabelë kualifikime Dept ShUB, 9.1 Kurrikula BU 2022-2023, 2.2. Kurrikula, plani mësimor, organigrama FBU, 2.3 Kurrikula, plani mësimor, struktura 2021-2022, Tabelat 60.1/2/3 Lista e stafit akademik me kohë të plotë, të pjesshme dhe administrative për vitet 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023.
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të	Në përmbushje të kërkesave të kriterit 7, institucioni ka vënë në dispozicion evidencat 21.1 Strategjia e kërkimit shkencor në FBM, 22.1 Strategjia e kërkimit shkencor DSHUB, 22.2 Lista e marrëveshjeve me IAL, 22.3 Lista e bizneseve bashkëpunuese me FBU 2018.



kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Rezulton se dy dokumentat e parë rregullojnë menyren se si bashkëveprohet me institucione të tjera në menyre që studentët të përfitojnë udhëheqje dhe mbikëqyrje cilësore në veprimtari të praktikës, diploma, etj. Dy dokumentet në vazhdim janë shembuj të aplikimit të rregulloreve.			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Informacioni i paraqitur në mbështetje të kriterit 8 përmban evidencat 22.2 Lista e marrëveshjeve me IAL, 22.3 Lista e bizneseve bashkëpunuese me FBU 2018 dhe model marrëveshje (evidenca 90.3). Evidencat e sipërcituara evidentojnë se IAL angazhohet për realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve përkatëse. Referuar këtyre marrëveshjeve personeli mbikqyrës në ambientin pritës ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve përfshirë këtu raportin përfundimtar të praktikës si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstanton se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.2

**Institucion<sup>2</sup> i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni ka ofruar evidencë në mbështetje të kriterit 1 si vijojnë: 26.1 Infrastruktura në aspektin mësimor në FBU, 26.2 Infrastruktura, lab në çdo department ku detajohen kategoritë e mjediseve në dispozicion të programeve mësimore, përfshirë MSH në BU. Gjithashtu, ofrohen dokumentat 19.1 Regjistri i studentëve MSH-BU i cili ofron të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar në vitet akademike 2010 dhe 2021, respektivisht 18 dhe 13 studentë. Gjithashtu, ofrohen dokumentat 21.02 Analiza e punës Mësimore Kërkimore 2021-2022 në DSHUB ku trajtohen situata dhe problematikat lidhur me mjediset në dispozicion të studentëve (pikat 2.7-2.9), dhe evidencë 21.4 Analiza mësimore Shkencore 2019-2020 UBT (pika 3.4) sipas të cilit për vitin akademik 2019-2020 kanë qënë në përdorim të FEA-s 53 salla mësimi, nga të cilat 16 salla leksionesh, 7 prej tyre janë me kapacitet nga 52 deri në 79 vende dhe 9 salla janë me kapacitet mbi 150 vende, ndërkohë që numri maksimal i studentëve në ciklin Bachelor dhe Master është 120-150.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të	Në mbështetje të kriterit 2 institucioni ka ofruar dokumentat si vijojnë: 25. Lista e paisjeve të laboratorëve, ku detajohen gjithë infrastruktura

<p>tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>laboratorike; 26.1 Infrastruktura në aspektin mësimor në FBU, 26.2 Infrastruktura, lab në çdo department ku detajohen kategoritë e mjediseve në dispozicion të programeve mësimore, përfshirë MSH në BU. Laboratorët rezultojnë të paisur me aparatura bashkëkohore në shërbim të moduleve dhe realizimit të aspekteve mësimore teorike dhe laboratorike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelierët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në mbështetje të kriterit 3 institucioni ka ofruar dokumentat si vijojnë: 25. Lista e paisjeve të laboratoreve, ku detajohen gjithë infrastruktura laboratorike; 26.1 Infrastruktura në aspektin mësimor në FBU, 26.2 Infrastruktura, lab në çdo department ku detajohen kategoritë e mjediseve në dispozicion të programeve mësimore, përfshirë MSH në BU. Laboratorët rezultojnë të paisur me aparatura bashkëkohore në shërbim të moduleve dhe realizimit të aspekteve mësimore teorike dhe laboratorike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në mbështetje të kriterit 4 institucioni ka ofruar dokumentat si vijojnë: 25. Lista e paisjeve të laboratorëve, ku detajohen gjithë infrastruktura laboratorike; 26.1 Infrastruktura në aspektin mësimor në FBU, 26.2 Infrastruktura, lab në çdo department ku detajohen kategoritë e mjediseve në dispozicion të programeve mësimore, përfshirë MSH në BU. Laboratorët rezultojnë të pajisur me aparatura bashkëkohore në shërbim të moduleve dhe realizimit të aspekteve mësimore teorike dhe laboratorike. Në mbështetje të kriterit 4 ofrohet evidenca 90.4 (lista e paisjeve të laboratorit të informatikës ofruara nga projekti NETCHEM).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Në mbështetje të kriterit 5 institucioni ka venë në dispozicion evidencat 21.1 Strategjia e kërkimit shkencor në FBM, 22.1 Strategjia e kërkimit shkencor DSHUB, 22.2 Lista e marrëveshjeve me IAL, 22.3 Lista e bizneseve bashkëpunuese me FBU 2018. Rezulton se dy dokumentat e parë rregullojnë mënyren se si bashkëveprohet me institucionet e tjera në mënyrë që studentët të përfitojnë udhëheqje dhe mbikëqyrje cilësore në veprimtaritë e praktikës, diploma, etj. Dy dokumentet në vazhdim janë shembuj të aplikimit të rregulloreve.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</i></p>


Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka ofruar dokumentat si vijojnë: 2.1 Syllabuse të bashkuara MSc-BU, në të cilën jepen në mënyrë të detajuar tekstet mësimore në shërbim të përvetësimit të dijeve nga studentët për çdo disiplinë; 23.1 Informacion mbi Bibliotekën FBU, 23.2 Informacion mbi Bibliotekën-hyrje të reja, ku përshkruhen titujt kryesorë, dhe 29. Lista e librave nga projekti CONCUS, i cili përmban literaturë të përshtatshme për programin e studimit MSHBU.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka ofruar dokumentat si vijojnë: 23.1 Informacion mbi Bibliotekën FBU, 23.2 Informacion mbi Bibliotekën-hyrje të reja, ku përshkruhen titujt kryesorë, dhe 29. Lista e librave nga projekti CONCUS, i cili përmban literaturë të përshtatshme për programin e studimit MSHBU. Bazuar në këto evidenca GVJ konstanton se IAL raporton përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. Këto përditësime konstantohen në fondin e bibliotekës të pasuruar nëpërmjet projekteve dhe të reflektuara në programet lëndore (evidenca 2.1).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në mjediset e UBT gjendet Biblioteka "Mentor Permeti" e përshkruar në dokumentin 26.1 Infrastruktura në aspektin mësimor në FBU. Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka ofruar gjithashtu dokumentat si vijojnë: 23.1 Informacion mbi Bibliotekën FBU, 23.2 Informacion mbi Bibliotekën-hyrje të reja dhe 44.1 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore. Këto dokumenta evidentojnë se IAL u ofron studentëve bibliotekën mësimore dhe u jep atyre mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Informacioni i detajuar mbi fondin fizik të bibliotekës së UBT paraqitet në RVB (St IV, Kriteri 4). Bazuar në të egzistojnë 20000 libra në shqip dhe gjuhë të huaj, dhe 10000 volume periodikësh, të sistemuar në një hapësirë prej 1300m <sup>2</sup> . Gjithashtu, jepet informacion mbi një tjetër librari moderne me kapacitet mbi 100 vende, të paisur me 12 kompjutera. Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka ofruar gjithashtu dokumentat si vijojnë: 23.1 Informacion mbi Bibliotekën FBU, 23.2 Informacion mbi Bibliotekën-hyrje të reja dhe 44.1 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të	Në listën e evidencave në mbështetje të këtij kriteri gjenden dokumentat: 23.1 Informacion mbi Bibliotekën FBU, 23.2 Informacion mbi

<p>barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Bibliotekën-hyrje të reja dhe 44.1 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore.</p> <p>Gjithashtu, informacion ofrohet ne RVB, ku sqarohet se Biblioteka “Mentor Permeti” është anëtare e Konsorciumit të Librarive Shqiptare dhe si e tillë ka akses në burime online. Po ashtu ky dokument i referohet investimit të AADF (Fondit Shqiptaro-Amerikan te Zhvillimit) në kuadër të projektit “Clean Score”, i cili i jep akses bibliotekës në platformën JSTOR Hawaii.</p> <p>Sugjerojmë se në listën e evidencave mund të ishte përfshirë një dokument sqarues i kapaciteteve fizike te Bibliotekes se UBT.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>RVB sqaron se Biblioteka “Mentor Permeti” është anëtare e Konsorciumit të Librarive Shqiptare dhe si e tillë ka akses në burime online. Po ashtu ky dokument i referohet investimit të AADF (Fondit Shqiptaro-Amerikan te Zhvillimit) në kuadër të projektit “Clean Score”, i cili i jep akses bibliotekës në platformën JSTOR Hawaii.</p> <p>Gjithashtu, në këtë bibliotekë egziston një katalog online i titujve, që lehtëson përdorimin nga studentët dhe stafi të literaturës.</p> <p>Evidencat 23.1 Informacion mbi Bibliotekën FBU, 23.2 Informacion mbi Bibliotekën-hyrje të reja dhe 44.1 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore, ofrojnë informacion mbi materialet fizike dhe pasurimin e tyre kohë pas kohe.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Në përmbushje të këtij kriteri institucioni ka ofruar informacion në evidencën RVB (Fusha 4/ Kriteri 7) ku sqarohet se oraret e funksionimit të Bibliotekës janë publike, të vendosura në të dy godinat dhe të shpallura online, pra të aksesueshme nga studentët. Anëtarësia e bibliotekës është rreth 1300, të paisur me kartë anëtarësie, e cila lejon përdorimin e katalogut online të fondit te bibliotekes.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka “Mentor Permeti” ka një website të vetin ku paraqiten të dhënat mbi fondin; Ka një adresë të dedikuar emaili për komunikim me stafin dhe studentët, si edhe është e përfaqësuar në rrjetet sociale (RVB, fusha 4/ kriteri 8).</p> <p>Evidencat 23.1 Informacion mbi Bibliotekën FBU, 23.2 Informacion mbi Bibliotekën-hyrje të reja dhe 44.1 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekes shkencore, dëshmojnë përpjekjet për paraqitje të fondit dhe pasurim të tij ndër vite.</p>








<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstanton se programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën si dhe mjedise të posaçme).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Për menaxhimin e programit MSc në BU, Universiteti Bujqësor i Tiranës ka një sistem menaxhimi të tipit PITAGORA (sipas RVB), falë të cilit i gjithë informacioni nga regjistrimi deri në diplomim të studentëve është i siguar. Përveç kësaj, ky sistem shërben për njoftimin e studentëve për datat e provimeve, regjistrimin për provime, dhe vlerësimet e marra. Sekretaria e UBT mban regjistria të studentëve nga fillimi në përfundim të studimeve (RVB). Gjithashtu, Zyra e Karrierës e UBT ka hartuar një dokument mbi gjurmimin e punësimit të studentëve pas diplomimit (Evidenca 19.2). Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka depozituar edhe evidencë si 1.3.1 Rregullorja e studimeve në FBU, 3. Rregullore e Programit të studimit MSc BU, në të cilat trajtohet me kujdes mënyra e menaxhimit të informacioneve mbi studentët, si edhe 19.1 Regjistri i studentëve të MSc BU.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Për menaxhimin e programit MSc në BU, Universiteti Bujqësor i Tiranës ka një sistem menaxhimi të tipit PITAGORA (sipas RVB), i cili përmban gjithë informacionin mbi veprimtarinë e stafit akademik, ndihmësakademik dhe administrative, dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Në informacionin e depozituar nga institucioni gjenden gjithashtu Evidenca 21.01/Evidenca 21.02/Evidenca 21.03 respektivisht Analiza Mësimore Shkencore për vitet 2019-2020-2021-2022, në të cilat pasqyrohet dhe ruhet dokumentacioni në njësinë bazë.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Falë sistemit PITAGORA (sipas RVB), i gjithë informacioni nga regjistrimi deri në diplomim të studentëve është i siguar. Përveç kësaj, ky sistem shërben për njoftimin e studentëve për datat e provimeve, regjistrimin për provime, dhe vlerësimet e marra. Gjithashtu, akses mbi të dhënat ofrohet përmes: <a href="http://www.esse.gov.al">www.esse.gov.al</a> <a href="http://www.sekretariatUBT">www.sekretariatUBT</a> <a href="http://www.ubt.pitagora.rash.al/login">www.ubt.pitagora.rash.al/login</a>

<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit PITAGORA (sipas RVB) ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit midis studentëve dhe stafit.</p> <p><a href="http://www.esse.gov.al">www.esse.gov.al</a>  <a href="http://www.sekretariatUBT">www.sekretariatUBT</a>  <a href="http://www.ubt.pitagora.rash.al/login">www.ubt.pitagora.rash.al/login</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi PITAGORA është sistem online që mundëson aksesin e dëshiruar të informacionit në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> <p><a href="http://www.esse.gov.al">www.esse.gov.al</a>  <a href="http://www.sekretariatUBT">www.sekretariatUBT</a>  <a href="http://www.ubt.pitagora.rash.al/login">www.ubt.pitagora.rash.al/login</a></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Bazuar në RVB, UBT në përmbushje të detyrimeve të Ligjit Nr. 119/2014, Neni 4 Mbi të drejtën e informimit, publikon në website-in zyrtar informacione mbi programet mësimore, stafin, veprimtaritë, në të paktën dy gjuhë njëra prej të cilave shqip.</p> <p><a href="http://www.UBT.edu.al">www.UBT.edu.al</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka ofruar Evidencën 28 Detajim buxheti i miratuar për 2022, ku tregohet mënyra e planifikimit për vitin respektiv si dhe Evidencën 90.6 (Plan financiar dy vjeçar). Njëherësh, në Ev.RVB sqarohet se Drejtoria Financiare e UBT harton një plan financiar afat-mesëm, i cili rinovohet çdo vit duke marrë në konsideratë nevojat e departamenteve për realizimin e programeve të studimit.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 28 Detajim buxheti i miratuar për 2022 ky kriter plotësohet. Referuar evidencës 28, GVJ-konstanton se plani i financimit të njësisë bazë e cila është përgjegjëse për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor-kërkimor, shpenzimet për bibliotekën, pasurimin e saj me literaturë, kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të programit si dhe projekte të ndryshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UBT bazuar në RVB, kryen audit të brendshëm të përvitshëm me anë të njësisë së brendshme të auditit (evidenca 90.9, Raportim vjetor audit i brendshëm). Raporti financiar përmban të dhëna mbi të ardhurat nga regjistrimet dhe kontributet e tjera, dhe reflekton ndarjen e shpenzimeve në kategori, si pagesa, qera, shpenzime administrative, shpenzime për kërkimin shkencor, etj. sipas legjislacionit në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Mënyra e hartimit të buxheteve të përvitshme në UBT kryhet në bashkëpunim me departamentet dhe bazuar në kërkesat e tyre. Sipas RVB, raportet financiare vjetore të tri viteve të fundit janë të depozituara.</p> <p>Në mbështetje të këtij kriteri insitucioni ka ofruar Evidencën 28 Detajim buxheti i miratuar për 2022, ku tregohet mënyra e planifikimit për vitin respektiv.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Planifikimi Financiar vjetor i sqaruar ne Evidencën 28 Detajim buxheti i miratuar për 2022, është përdorur për të treguar sesi UBT punon për qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit përmes kategorive të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>Këtij dokumenti i referohet edhe RVB.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Politikat dhe procedurat e ndjekura nga UBT prej regjistrimit të studentëve deri në diplomim përshkruhen në Rregulloren e UBT (Evidenca 1.11), në Rregulloren e FBU (Evidenca 1.3.1) dhe në Rregulloren e Programit të studimit MSc në BU (Evidenca 3). Për implementimin e politikave dhe procedurave shërben një strukturë e konsoliduar e përbërë nga Dega e Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe Ndhmës Institucionale, dhe Dega e Informimit dhe Transferimit të Teknologjisë. Këto struktura adresojnë dhe administrojnë problematika të procesit të të mësuarit dhe zhvillimit të karrierës të studentëve të UBT nga hyrja deri në diplomim (Evidenca 46). Departamenti i Shkencave Ushqimore dhe Bioteknologjisë në bashkëpunim me strukturat e sipërpërmendura ndërmer veprimtari në mbështetje të mësimdhënies dhe zhvillimit të karrierës, të tilla si fushata të promovimit të programit dhe të kriterëve të pranimit në të. Njëherësh, njësia bazë mbështet veprimtari për zhvillimin e karrierës të tilla si informime mbi mundësi internship-i, punësimi, pjesëmarrje në konferenca, trajnime, evente sportive, etj (Evidenca 79). Gjithashtu, Qendra e Karrierës për studentët komunikon me studentët dhe koordinon veprimet me sekretariatet e departamenteve, dhe administratorin e universitetit duke zgjidhur një mori problematikash (Evidenca 46).
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Kriteret e pranimit në Programin MSc. në BU hartohen në përputhje me Ligjin 80/2015, Neni 74, dhe miratohen nga rektorati i UBT dhe Senati Akademik. Ndjekja e zbatimit të dokumentave të miratuara kryhet nga Zv Rektori për Edukimin, Zyra e Zhvillimit të Karrierës, Zyra për Studentët dhe Studimet. Dokumenta si Rregullore e FBU (Evidenca 1.3.1) dhe (Evidenca 56). Mënyra e pagesës për regjistrimin në FBU, përshkruajnë procedurat që ndiqen në këtë kuadër. Pas regjistrimit në

	sekretarinë e fakultetit studentët plotësojnë edhe regjistrimin në sistemin elektronik PITAGORA: <a href="https://www.ubt.pitagora.rash.al/login">https://www.ubt.pitagora.rash.al/login</a> , i cili ju mundëson të informohen mbi datat/oraret/vlerësimet, etj. në vazhdim të studimeve (Evidenca 80).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Hartimi dhe miratimi i kriterëve të pranimit në programin MSc. në BU bëhet çdo vit akademik në përputhje me (Evidenca 1.3.1) Rregullorja e studimeve në FBU. Njësia bazë në bashkëpunim me Qendrën për Karrierën dhe Zyrën për Studentët & Studimet përgatisin një paketë informuese për aplikantët e interesuar të ndjekin studimet (Evidenca. RVB). Programet, kuotat dhe kriteret respektive publikohen në portalin U-Albania dhe website e UBT. Kriteret e pranimit në programin MSc. në BU bëhen publike nga fakulteti në website-in: <a href="https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/R3.26FBU-Shkenca-e-Ushqimit-dhe-te-Utrehrit.pdf">https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/R3.26FBU-Shkenca-e-Ushqimit-dhe-te-Utrehrit.pdf</a> Ato janë në përputhje me përcaktimet e dhëna në (Evidenca 3. Rregullorja e Programit të studimit MSc në BU). Gjithashtu, në website-in e UB jepet informacion mbi kuotat për çdo program studimi. ( <a href="https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/Kuotat-Cikli-i-pare-dhe-i-dyte-UBT.pdf">https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/Kuotat-Cikli-i-pare-dhe-i-dyte-UBT.pdf</a> )
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit për gjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procedura për hartimin e kriterëve të pranimit në programin MSc në BU fillon në njësinë bazë, më pas miratohen nga Senati i UBT dhe i përcillen MAS. Rregullat e pranimit në këtë program përkrahohen në Evidenca 3. Rregullorja e Programit të studimit në MSc. në UBT për të rregulluar transferimin dhe njohjen e studimeve të mëparshme dhe/ose të pjesshme IAL njihet kreditet e përfuara nga programet Master Profesional për disiplinat me e krahasueshme (Evidenca 3). Gjithashtu, IAL në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë (Evidenca 57), përcjell listën e studentëve të regjistruar drejt QSHA. Studentët dhe të interesuarit mund të marrin informacion mbi vlerësimet gjatë gjithë periudhës së studimeve në sistemin PITAGORA duke përdorur adresat personale (Evidenca 58. Manuali i regjistrimit në sistemin online PITAGORA).
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informimi i publikut mbi kërkesat dhe kriteret e pranimit në Programin MSc në BU kryhet në disa mënyra: Broshurave, fletëpalosjeve, guidave, faqes web të UBT, dhe platformave sociale facebook/instagram. Në mbështetje për sa më sipër institucioni ka ofruar Evidencat 59.1-59.7.
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të	Pjesë e procedurave për hartimin dhe publikimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit të UBT është edhe përcaktimi i përvitshëm i kuotave për kategoritë aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këto i përcillen për miratim MAS dhe hartohen në

pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	përputhje me Rregulloren e Programit të studimit respektiv dhe atë të UBT. Regjistrimi kryhet jo nëpërmjet portalit të maturës shtetërore, por drejtpërdrejt në UBT (Evidenca RVB).			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Pjesë e procedurave për hartimin dhe publikimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit të UBT është edhe përcaktimi i përvitshëm i kuotave për kandidatë nga shtete të tjera. Këto i përcillen për miratim MAS dhe hartohen në përputhje me Rregulloren e Programit të studimit respektiv (Evidenca RVB) dhe atë të UBT.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UBT harton politika të ndihmës përmes bursave për shtresat në nevojë në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015 i datës 22.07.2015, VKM Nr. 784 i datës 21.12.2016, VKM Nr. 779 i datës 26.12.2018, VKM Nr. 269 i datës 29.03.2017, dhe VKM Nr. 780 e datës 26.12.2018 (sipas Evidenca RVB). Gjithashtu, referuar statutit të UBT (Evidenca 1.0), rezulton se IAL harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë si dhe politika për të rritur cilësinë e pranimit në programin e studimit me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstanton se UBT harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve gjatë gjithë periudhës së studimit, sqarohen nga Rregullorja e UBT (Evidenca 1.11), Rregullorja e FBU (Evidenca 1.3.1) dhe Rregullorja e Programit MSc. në BU (Evidenca 3). Rregulloret e sipërpërmendura evidentojnë se IAL vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve si dhe kalimit të tyre nga një vit akademik në tjetrin.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Kriteret dhe procedurat për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve janë të përcaktuara në rregulloret e njësive bazë, të cilat janë hartuar në përputhje me Ligjin në fuqi për IAL si Rregullorja e FBU (Evidenca 1.3.1), Rregullorja e DZHKKVI (Evidenca 46). Njoftimi i studentëve për mundësitë e transferimeve dhe llogaritjen e krediteve të marra kryhet përmes Zyrës së Studentëve dhe Studimeve, dhe Zyrës së Karrierës (Evidenca 54), dhe Degës për Informim, Orientim dhe

	Karrierë të studentëve (Evidenca 55). Gjithashtu, politika e lëvizjes së studenteve ERASMUS është përfshirë në Evidenca 1.3.1.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në mbështetje të këtij kriteri instucioni ka ofruar evidencat 1.11 Rregullore e UBT, kap IX, nenet 56-58, Rregulloren e FBU, Kap IX (Evidenca 1.3.1), dhe Evidenca 81- “Shembull i një procesverbali provimi i firmosur nga gjithë palët”. Njëherësh njoftimi i studentëve mbi vlerësimet kryhet me anë të sistemit online PITAGORA. Këto evidenca provojnë se UBT si dhe Njësia Kryesore/Njësia Bazë informojnë studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Informimi i studentëve mbi kriteret e procedura të punimit të diplomës në UBT mbështetet në Rregulloren e UBT (Evidenca 1.11, kap XII, Neni 85). Në mbështetje tv parashikimeve të këtij dokumenti, studentëve ju ofrohet perveç Diplomës (Evidenca.14.1) edhe Suplementi i diplomës (Evidenca 14.2), të cilat së bashku përmbajnë paketën e plotë të informacionit mbi natyrën e nivelit, përmbajtjes dhe rezultateve të arritura nga studenti.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Informacionet mbi programin MSc. në BU bëhen publike nga fakulteti në website-in: <a href="https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/R3.26FBU-Shkenca-e-Ushqimit-dhe-te-Utrehrit.pdf">https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/R3.26FBU-Shkenca-e-Ushqimit-dhe-te-Utrehrit.pdf</a> Ato janë në përputhje me percaktimet e dhëna në (Evidenca 3. Rregullorja e Programit te studimit MSc. në BU). Gjithashtu, në website-in e UBT jepet informacion mbi kuotat për çdo program studimi ( <a href="https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/Kuotat-Cikli-i-pare-dhe-i-dyte-UBT.pdf">https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/Kuotat-Cikli-i-pare-dhe-i-dyte-UBT.pdf</a> ) Për të mbështetur informimin e publikut mbi kërkesat dhe kriteret e pranimit në Programin MSc. në BU institucioni ka ofruar evidencë si Broshura, fletëpalosjeve, guidave, faqes web të UBT, dhe platformave sociale facebook/instagram (Evidencat 59.1-59.6).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstanton se UBT vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin Master i Shkencave në Bioteknologji Ushqimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ofron evidencat 59.1-59.7 si broshura, fletëpalosjeve, guidave, faqes web të UBT, dhe platformave sociale facebook/instagram të cilat gjenden përveçse pranë njërive bazë edhe në website-in e UBT dhe përdoren përpara fillimit të çdo viti akademik në fushata për informimin e studentëve (Evidenca RVB).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentëve që regjistrohen në MSc. në BU ju vihen në dispozicion dokumentat 59.1 Broshura e programeve të studimit në UBT, 59.2. Fletëpalosje e FBU, 59.5 Guida e studimeve në FBU. Gjithashtu informacioni i detajuar mbi disiplinat gjendet në website-in e UBT. GVJ konstanton se evidencat e mësipërme provojnë se IAL vë në dispozicion të studentëve informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për lëndët dhe modulet. Ato përmbajnë informacionin e duhur për veprimtaritë formuese të programit të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Qendrës për Karrierën e Studentëve DIOKS e cila funksionon bazuar në rregulloren e posaçme (Evidenca 55), harton një raport të gjurmimit të studentëve (Evidenca 83) pas diplomimit. Njëherësh kjo zyrë ndjek me kujdes dhe orienton studentët drejt karrierës bazuar në Listen e marrëveshjeve të UBT me biznese (Evidenca 22.3). Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë ka hartuar një dokument mbi Studimin e Tregut të punës për të diplomuarit në programin MSc. në BU (Evidenca 4). Modeli i marrëveshjes me një biznes është gjithashtu pjesë e paketës së dokumentave të ofruara nga institucioni (Evidenca 82).
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni mbi zhvillimin, organizimin, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet ju ofrohet studentëve nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta në auditor (sipas RVB), nëpërmjet website të UBT, dhe nëpërmjet materialeve të printuara të tipit broshura, fletëpalosje, njoftime, etj (Paraqitja e kurrikulës në WEB site).
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni (Paraqitja e kurrikulës në WEB site, si edhe sistemi i brendshëm i menaxhimit PITAGORA), konstantohet se informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se UBT vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren e DZHKKVI, neni 32, fq. 26, (Evidenca 46) UBT ka struktura për ruajtjen e të dhënave të studentëve dhe përpunimin statistikor të tyre, si Arkivi Qendror i UBT, Zyra e Studentëve dhe Studimeve (evidenca 90.8, Statistikat vjetore të studentëve). Kjo evidenton se IAL disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve, në programin e studimit. Në këtë mënyrë IAL mbledh, administron, ruan dhe përditëson informacione të hollësishme në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Bazuar në RVB, Zyra e Studentëve dhe Studimeve në UBT ruan në rregjistra të dhenat e studentëve dhe i përpunon ato statistikisht, për të evidentuar numrin e të regjistruarve, të diplomuarve, të larguarve, apo të transferuarve (evidenca 90.8, Statistikat vjetore të studentëve). Për sa më sipër GVJ vlerëson se UBT disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre. Referuar evidencës 90.8 (statistika vjetore të studentëve) IAL përmban gjithashtu informacione të detajuara në lidhje me studentët që janë larguar apo tërhequr nga programi i studimit si dhe të atyre që nuk kanë përfunduar me sukses vitin akademik.
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga informacioni i ofruar rezulton se sistemi i brendshëm online PITAGORA është vendi i menaxhimit të të dhënave të studentëve (evidenca 90.5, Autorizim Pitagora). Si i tillë është lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar. Kriteri plotësohet bazuar në Evidencën 46. Rregullorja e DZHKKVI, neni 12, fq. 10 dhe Evidencën 90.5, Autorizim Pitagora.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me	Kriteri plotësohet bazuar në Evidencën 46 Rregullorja e DZHKKVI, neni 12, fq. 10. Referuar kësaj rregulloreje konstantohet se IAL mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse. Në këtë mënyrë IAL siguron menaxhimin e të gjithë këtij procesi dhe vlerëson e dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.				
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në Evidencën 21.01 dhe Evidencën 21.02-Analiza e punës mësimore-kërkimore DSHUB 2020-2021; 2021-2022, GVJ konstanton se Njësia Bazë harton raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Gjithashtu referuar evidencave të sipërcituara, GVJ vlerëson se Njësia Bazë përfshin në këto raporte/analiza informacione në lidhje me shkallën e cilësisë së punësimit të studentëve, dhe i shoqëron ato me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson se UBT mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni rezulton se UBT parashikon në Statutin e tij (Evidenca 1.0) përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese. Evidenca 86 Vendim i KZF mbi fituesit për KSCPSKSH, dhe Evidenca 87. Vendim i Komisionit Institucional Zgjedhor të UBT mbi përfaqësuesin e studentëve në Bordin e Administrimit janë gjithashtu vendime që provojnë sa më sipër.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Të drejtën për përfshirje të studentëve në vendimmarrje, këshillim, vlerësim të procesit akademik, të dhënë nga Ligji në fuqi për IAL, dhe të përfshirë në Statutin e UBT (neni 37), e provojnë dokumentat si Evidencën 79-Raport i performancës së QKA 2019-2020, pjesëmarrja në ekipet e promovimit të programeve të UBT, dhe pjesëmarrja në veprimtari social-kulturore-sportive (Evidenca 88.1, 88.2, 90.5).
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të	Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni rezulton se UBT parashikon në Statutin e tij (Evidenca 54) përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese. Evidenca 86 Vendim i KZF mbi fituesit për KSCPSKSH, dhe Evidenca 87. Vendim i Komisionit Institucional Zgjedhor të UBT mbi përfaqësuesin e studentëve në Bordin e Administrimit janë gjithashtu vendime që provojnë sa më sipër. Pjesëmarrja e studentëve në këto organizime i

përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	shërben përfshirjes së tyre në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Evidenca 77-Pyetsor për studentët Fokus grup me studentët e FBU e mbështet sa me sipër.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në Evidencën 3. Rregullore e FBU, Kap IX, GVJ vlerëson se studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Gjithashtu, studentëve të programit të studimit u jepet mundësia e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e IAL/ Njësisë Kryesore/Njësisë Bazë dhe pedagogut përgjegjës			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstanton se UBT përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Bazuar në Evidencën 46 (Neni 41, pg. 33) "Mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional-DZHKKVI", UBT ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në mbështetje të parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore. Këtu përfshihen pritja e studentëve, orientimi, këshillimi si dhe mexhami i ankimimeve apo problematikave të ndryshme. Të gjitha këto procedura janë të përhershme dhe lehtësisht të arritshme nga studentët e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Bazuar në Evidencën 46 (Neni 41, pg. 33) "Mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional-DZHKKVI", UBT ka një sistem të posaçëm në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në mbështetje të parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore. Gjithashtu evidentojmë se në Evidencën 85 "Kurrikula e BU në faqen e web", dhe në website-in e UBT gjendet informacion i plotë mbi programin e studimit MSH BU: <a href="file:///C:/Users/pc/Downloads/Kurrikula_Master-i-Shkencave-ne-Bioteknologji-Ushqi.pdf">file:///C:/Users/pc/Downloads/Kurrikula_Master-i-Shkencave-ne-Bioteknologji-Ushqi.pdf</a>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit	Bazuar në Evidencën 46 (Neni 41, pg. 33) "Mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe

të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Vlerësimi Institucional-DZHKKVI”, Evidenca 79 ”Raport performance e QKA 2020”, Evidenca 79.2.”Raport Vlerësimi Panairi 2022”, dhe informacionin e ofruar ne website-in e UBT ( <a href="https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve">https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve</a> ; <a href="https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni">https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni</a> ; etj) ky kriter plotësohet. Referuar evidencave të sipërcituara GVJ vlerëson se Zyra e Këshillimit të Karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor. Kjo zyrë ndihmon studentët e programit të studimit për zgjedhjen dhe orientimin në praktikën profesionale si dhe dhe orientimin në tregun e punës.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Bazuar në (Evidenca 46 Neni 41, pg. 33) ”Mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional-DZHKKVI”, Evidenca 81 ”Raport i gjurmimit të studentëve të FBU-2021”, dhe informacionit në website-in e UBT ( <a href="https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve">https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve</a> ; <a href="https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni">https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni</a> ; etj) ky kriter plotësohet. Për sa më sipër Zyra e Këshillimit të Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Këto informacione vihen në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se UBT ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme dhe janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e	Bazuar në dokumentacionin e ofruar, UBT ka pjesë të Planit të tij Strategjik (Evidenca 1.0.1) përgatitjen e udhëzuesve për përdorimin e metodave të ndryshme innovative të mësimdhënies. Kjo materializohet

<p>metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>në Evidencën 33.3 (Udhëzues për zhvillimin e mësimimit në distancë), Evidencën 35 (Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies), Evidencën 44.1 (Pasurimi i koleksionit të bibliotekës shkencore, Evidencën 51 (<a href="http://sluss-albania.libguides.com">http://sluss-albania.libguides.com</a>), Evidenca 44 (Linku i katalogut online <a href="https://al.cobbis.net">https://al.cobbis.net</a>).</p> <p>Referuar evidencave të mësipëme GVJ vlerëson se IAL harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve dhe programeve lëndore.</p> <p>Bazuar në sa më sipër (dhe përdorimin e tyre gjatë periudhës së pandemisë) kriteri plotësohet.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>UBT ka zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Në mbështetje të sa më sipër, UBT ka paraqitur Evidencën 34.2 Vendim Senati-Anketimi Studentor-Pyetëtori 2018-2019, dhe Evidencën 30.4 (Vlerësimi periodik i stafit ndihmës-akademik 2020).</p> <p>Bazuar në këto evidenca konstantohet se ekzistojnë strukturat përkatëse të cilat zhvillojnë mekanizmat e monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe atij ndihmësakademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>UBT në analizat vjetore të mësimdhënies dhe kërkimit ndër të tjera paraqet rezultatet e pyetësorëve të studentëve (Evidenca 21.4.1). Në mbështetje të sa më sipër janë ofruar edhe një model pyetësori për studentët-format tip (Evidenca 31.1, i vitit 2016-2017) dhe (Evidenca 34.2 Anketimi i studentëve-pyetëtori 2018-2019).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, respektivisht Departamenti i BU, FBU, DZHKKVI, Asambleja e FBU, kontribuojnë në përgatitjen e raporteve të përvitshme mbi sa më sipër (Ev. RVB). Institucioni ka ofruar Evidenca 21.02 (Analiza e punës mësimore-kërkimore DSHUB 2021-2022); Evidenca 21.5 (Miratimi i Analizës mësimore-kërkimore 2021; Evidenca 21.2.1 (Analiza mësimore-kërkimore FBU 2021-2022) dhe Evidenca 37 (Thirrje e mbledhjes së Asamblesë së FBU), bazuar në të cilat ky kriter plotësohet.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Analizat mësimore-kërkimore të njësisë bazë dhe FBU (Evidenca 21.02- "Analiza e punës mësimore-kërkimore DSHUB 2021-2022"), si edhe mbledhjet e Asamblesë së FBU i shërbejnë promovimit të praktikave të mira, dhe nxitjes drejt tyre. Gjithashtu, në website-in e UBT gjendet informacion mbi projektet, etj. në cilat është i angazhuar stafi, çka i shërben gjithashtu promovimit.</p> <p><a href="https://www.ubt.edu.al/projektet">https://www.ubt.edu.al/projektet</a>  <a href="https://www.ubt.edu.al/sigurimi-i-cilesise">https://www.ubt.edu.al/sigurimi-i-cilesise</a></p>



	Për sa më sipër, GVJ vlerëson se IAL nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira dhe nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstanton se UBT ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Evidencën 46 (Neni 41, pg. 33) "Mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional-DZHKKVT", Evidenca 79 "Raport performance e QKA 2020", Evidenca 79.2 "Raport Vlerësimi Panairi 2022", informacionin e ofruar në website-in e UBT ( <a href="https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve">https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve</a> ; <a href="https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni">https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni</a> , Evidenca 50 (Organigrama e FBU) Evidenca 48 (Vendimi i KIZ për Komisionet e FBU), sqarohet se UBT ka politika, struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Referuar Statutit (evidenca 1.0) të IAL vërehet se procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në Evidencën 1.0.1 (Strategjia e UBT), dhe Evidencën 1.2.0 (Manuali i cilësisë i UBT), institucioni ka një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Njëherësh, bazuar në Evidencën 1.6.1 (Raporti i vlerësimit të brendshëm-2018), Evidenca 34.1 (Pyetësor për studentët, dhe Evidenca 34.3 (Pyetësor për stafin akademik dhe ndihmës-akademik) në procesin e vlerësimit marrin pjesë strukturat, stafi dhe studentët. Referuar evidencave të mësipërme, GVJ vëren se Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në UBT zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në këtë kuadër konstantohet se zbatohen politika e procedura transparente dhe të posaçme në të cilat përfshihen edhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë	DSHUB aplikon për herë të parë për akreditimin e programit MSc. përmes vlerësimit të jashtëm. Ndërkohë, UBT është akredituar sipas këtij sistemi në vitet 2017 dhe 2021 (Evidenca 1.1.3, Evidenca 1.1.2). Në këtë kuptim kriteri plotësohet.

realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Matja e treguesve të mësimdhënies dhe kërkimit është mundësuar përmes hartimit të pyetësorëve të detajuar për studentët (Evidenca 34.1, 34.2), për stafin akademik dhe ndihmës akademik (Evidenca 34.3); Pasqyrimi i gjëndjes është provuar me anë të Raportit të vlerësimit të brendshëm (Evidenca 1.6.1); Evidenca 21.02 (Analiza e punës mësimore-kërkimore DSHUB 2021-2022), si edhe mbledhjet e Asamblesë së FBU i shërbejnë promovimit të praktikave të mira, dhe nxitjes drejt tyre. Gjithashtu, në website-in e UBT gjendet informacion mbi projektet, etj. në cilat është i angazhuar stafi, çka i shërben gjithashtu promovimit. <a href="https://www.ubt.edu.al/projektet">https://www.ubt.edu.al/projektet</a> <a href="https://www.ubt.edu.al/sigurimi-i-cilesise">https://www.ubt.edu.al/sigurimi-i-cilesise</a> Për sa më sipër konstantohet se UBT përdor tregues të qartë e të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Ato pasqyrojnë arritjet dhe dobësitë, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e këtyre treguesve, UBT bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se UBT harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira,	Në UBT Zyra e Kurrikulave është përgjegjëse për hartimin, monitorimin, miratimin dhe marrjen e masave për përmirësim të programeve të studimit (Evidenca 46. Rregullorja e DZHKKVI; Evidenca 2.3 Kurrikula Plani Mësimor 2021-2022; Evidenca 45 Parashikim ngarkese për 3 vitet e fundit). Në bashkëpunim me DSHUB, dekanatin e FBU, Asamblenë e FBU, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë harton raporte periodike (Evidenca 1.7.2 Raporti i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë 2021-2022).

<p>dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në Raportimet në nivel departamenti (Evidenca 21.01 Analiza Mësimore-Kërkimore 2020-2021 DSHUB), fakulteti (Evidenca 21.4.1 Analiza FBU 2021-2022), rektorati (Evidenca 21.4 Analiza mësimore-kërkimore UBT 2019-2020; Evidenca 21.4.0 Analiza mësimore-kërkimore UBT 2021-2022) dhe komisionesh (Evidenca 1.7.2 Raport i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë FBU), kriteri plotësohet. Evidencat e sipërcituara provojnë se Njësia Kryesore/Njësia Bazë përfshin në raportet e vlerësimit rezultatet e pritshme, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira. Në këto raporte/anlaiza përfshihen gjithashtu masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim shkencor nga stafi akademik dhe studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në Raportimet në nivel departamenti (Evidenca 21.01 Analiza Mësimore-Kërkimore 2020-2021 DSHUB), fakulteti (Evidenca 21.4.1 Analiza FBU 2021-2022), rektorati (Evidenca 21.4 Analiza mësimore-kërkimore UBT 2019-2020; Evidenca 21.4.0 Analiza mësimore-kërkimore UBT 2021-2022) dhe komisionesh (Evidenca 1.7.2 Raport i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë FBU), si edhe bazuar në pyetësorët për studentët (Evidencat 34.1, 34.2) dhe pyetësor për stafin akademik dhe ndihmës akademik (Evidenca 34.3), konkludohet se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në kuadër të këtyre metodave, vlerësohet se IAL siguron mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, vlerësim të didaktikës, kurrikulës së programit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Gjithashtu, konstantohet se personeli akademik kryen vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve apo praktikave laboratorike nga ana e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të</p>	<p>Pranë dekanatit të FBU funksionon një grup ad-hoc për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programeve mësimore (Evidenca 1.3.1 Rregullorja e FBU), i cili vepron bazuar në pyetësorët për studentët (Evidencat 34.1, 34.2) dhe pyetësorë për stafin akademik dhe ndihmës-akademik (Evidenca 34.3). Mbështetur në sa më sipër, konkludohet se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>



tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.									
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vëren se UBT/Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Përfshirja e aktorëve të brendshëm në sigurimin e cilësisë në programet e UBT është e rregulluar në dokumenta si Evidenca 1.4 Rregullorja e DSHBU, dhe Evidenca 1.2.1 Rregullorja e FBU. Përfshirja e aktorëve të jashtëm ka të bëjë me procesin e vlerësimit të jashtëm përmes akreditimit dhe marrëveshjet me bizneset.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Detyrat për çdo aktor (studentë, staf, komisione, degë, zyra) në skemën e sigurimit të brendshëm të cilësisë bazohen në Rregulloren e FBU (Evidenca 1.3.3) dhe në Manualin e Cilësisë në UBT (Evidenca 1.2.0). Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit për sigurimin e cilësisë mbështeten me Evidenca 48 Vendimi për komisionin KIZ të FBU.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e institucionit njësia bazë dhe ajo kryesore përfshihen në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë bazuar në rregulloret specifike (Evidenca 1.4; Evidenca 1.3.1) dhe e ushtron veprimtarinë përmes hartimit të kurrikulës, ndjekjes dhe analizave vjetore (Evidenca 2.1 Syllabuse të bashkuara, Evidenca 2.3 Kurrikula Plan Mësimor 2021-2022). Në shërbim të sa me sipër paraqitet Evidenca 1.2.0 Manuali i cilësisë. Referuar evidencave të mësipërme si dhe nga takimet e zhvilluara në IAL, GVJ vëren se në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e njësive bazë dhe asaj kryesore, përgjegjëse për programin e studimit. Në këtë vlerësim përfshihen gjithashtu,

	personeli akademik, ndihmësakademik, personeli administrativ si dhe studentët e programit të studimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Statuti i UBT parashikon respektimin e integritetit akademik dhe shmangjen e diskriminimit. Kjo realizohet në bashkëpunim nga Komisioni e Etikës dhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë (RVB).			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Pjesëmarrja e aktorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, është kryer përmes konsultimit me biznese dhe operatore të tjerë me të cilët UBT ka marrëveshje bashkëpunimi.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Gjetjes e GVJ-së janë se UBT përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politika, strategjia dhe organizimi i veprimtarive në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin MSc. në BU janë bazuar në rregulloret specifike (Evidenca 1.4; Evidenca 1.3.1) dhe e hartimit të kurrikules, ndjekjes dhe analizave vjetore (Evidenca 2.1 Syllabuse të bashkuara, Evidenca 2.3 Kurrikula Plan Mesimor 2021-2022). Në shërbim të sa më sipër është edhe Evidenca 1.2.0 Manuali i cilësisë. Veprimtaritë bëhen transparente me anë të raportimeve (Evidenca 21.5 Miratimi i analizës mësimore-kërkimore; Evidenca 49 Shembull Raportimi AMK 2020-2021) në të gjitha nivelet e strukturës nga departamenti deri në asamblenë e FBU.</p> <p>GVJ vëren gjithashtu se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të sanksionuara në Statutin e UBT. Ato janë transparente dhe bëhen publike</p>

	për studentët dhe të gjithë të interesuarit dhe krijojnë Kulturën e Brendshme të Cilësisë.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni në përfundim të raportimeve mbi cilësinë e mësimdhënies në të gjitha nivelet (Evidenca 21.4), përcjell raportin për miratim drejt Senatit të UBT (Evidenca 1.0 Statuti i UBT, Neni 9, pika 3). Respektimi i lirisë akademike, etikës dhe legjislacionit për të dhënat personale sigurohen përmes Statutit dhe Rregullores së UBT.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sipas dokumentacionit të përcjellë nga UBT vlerësimi i brendshëm është kryer në nivelin e njësisë kryesore në vitin 2018 dhe 2021 në kuadër të procesit të akreditimit institucional. Në nivel programesh, për MSHBU kryhet për herë të parë në 2023. Nderkohë, vlerësimet periodike nga DSHBU dhe FBU (Evidenca 21.01 Analiza mësimore-kërkimore 2020-2021 DSHBU; Evidenca 21.4.1 Analiza mësimore-kërkimore FBU-2021-2022) dëshmojnë marrjen e masave për përmirësimin e mangësive.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sigurimi i efektivitetit mundësohet nga kontrolli periodik i ushtruar nga Komisioni për cilësinë dhe kurrikulat, i cili funksionon bazuar në Rregulloren e FBU (Evidenca 1.3). Gjithashtu, raportimet periodike nga njësia bazë, dekanati, dhe miratimi në Senat janë hallka të sigurimit të efektivitetit të ndikimit të veprimtarive monitoruese.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërënjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Personeli dhe studentët mbahen të informuar mbi veprimtaritë për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit (RVB). Për këtë shërbejnë edhe pyetësorët për studentët dhe stafin (Evidenca 34.1 Pyetësor për studentët; Evidenca 34.2 Anketimi studentor; Evidenca 34.4 Pyetësor për stafin), analizat vjetore të departamentit të SHUB (Evidenca 21.01 Analiza mësimore-kërkimore 2020-2021 DSHBU), dhe publikimi në website-in e UBT i vendimeve të akreditimit aktual të UBT në 2017 dhe 2021.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Gjetjet se GVJ janë që politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë i Shkencave “Bioteknologji Ushqimore” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” është program i konsoliduar dhe i mirë strukturuar në shërbim të kërkesave të tregut të punës për këtë specialitet.
2. Staf i akademik i Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” ka kualifikim të lartë, dhe përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
3. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ofron infrastrukturë (auditore, laboratore, mjedise për praktika mësimore, bibliotekë) të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit, dhe është në proces përmirësimi të vazhdueshëm të tyre (një godinë e re në shërbim të programit do të jetë funksionale në Shtator 2023, dhe biblioteka e UBT vijon të pajiset me mjete online dhe tituj në shqip dhe gjuhë të huaj).
4. UBT, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, kryen vlerësime periodike të cilësisë së mësimdhënies në Programin Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore”. Për këtë shërben sistemi i brendshëm i menaxhimit institucional plotësisht funksional në të gjitha nivelet.
5. UBT ka procedurë dhe njësi të posaçme për këshillimin e studentëve, menaxhimin e nevojave të tyre gjatë viteve të shkollimit, dhe ndjekjen e nivelit të punësimit të tyre pas diplomimit.
6. Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, në koordinim me Fakultetin dhe Rektoratin, punon për të rritur më tej numrin e marrëveshjeve institucionale me universitete, institucione kërkimore (të huaja dhe vendore) dhe biznese, për të nxitur projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore dhe mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik (në mësimdhënie e kërkim).
7. Njësia bazë, ajo kryesore dhe Rektorati koordinojnë veprimtarinë në kuadër të marrëveshjeve me institucione dhe biznese për realizimin e praktikave profesionale nga studentët, dhe kanë rregulluar procesin e përfshirjes, supervizimit, verifikimit të rezultateve deri në përfundim të praktikave me rregullore të posaçme.



**Pika të dobta**

1. Përfshirja e studentëve të programit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” në projekte kërkimore mund të përmirësohet.
2. Përfshirja e studentëve të Programit Master i Shkencave në “Bioteknologji Ushqimore” në programet e mobilitetit mund të përmirësohet.
3. Laboratorët e kërkimit shkencor mund të pasurohen për të rritur kapacitetet për kërkim shkencor të avancuar.



## Rekomandime

1. GVJ rekomandon përfshirje më të gjerë të studentëve të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Bioteknologji Ushqimore" në programet e mobilitetit.
2. Rekomandohet përfshirje më e gjerë e studentëve të Programit të Studimit në projekte kërkimore.
3. Rekomandohet pasurimi i laboratorëve të kërkimit shkencor për të rritur kapacitetet në shërbim të kërkimit shkencor të avancuar.



**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Food Biotechnology" provided by the Higher Education Institution "Agricultural University of Tirana"**

**Strengths and affirmations**


1. The program MSc. in "Food Biotechnology" is a consolidated and well-structured program which serves the demands of the labor market for this specialty.
2. The academic staff of the Department of Food Sciences and Biotechnology engaged in the Program MSc. in "Food Biotechnology" is highly qualified and has experience in teaching and scientific research.
3. The Faculty of Biotechnology and Food has infrastructure (auditoriums, laboratories, facilities for professional practices, library), to fulfill the requirements of the study program, and is taking measures to improve it i.e. a new building in the service of the program will be operational in September 2023, and the AUT library is equipped with online tools and enriched with the books in Albanian and foreign languages.
4. Agricultural University of Tirana (AUT), the Faculty of Biotechnology and Food, in cooperation with the Department of Food Sciences and Biotechnology, conducts periodic evaluations of the teaching quality in the Program BSc. in "Food and Nutrition Sciences". To facilitate the process AUT has a fully functional internal institutional management system at all levels.
5. AUT has special procedures and units for advising students, managing their needs during their education years, and for tracking their employment after graduation.
6. The basic unit, the main unit and the Rectorate coordinate the activity within the framework of agreements with institutions and businesses for undertaking the professional internships by students, and have regulated the entire process to provide them supervision and step by step verification of results until the end of internships.

**Weaknesses**

1. The participation of Master program students in "Food Biotechnology" in research projects can be improved.
2. The participation of Master program students in "Food Biotechnology" in mobility programs can be improved.
3. Scientific research laboratories can be enriched to increase the capacities for advanced scientific research.

**Recommendations**

1. Review team recommends broader participation of the Study Program students in research projects.
2. Review team recommends broader participation of the Study Program students in mobility programs.
3. Review team recommends enrichment of scientific research laboratories to increase capacities in the service of advanced scientific research.



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

